

Raportimi i medias mbi Reformën në Drejtësi

Periudha e monitorimit: Tetor-Dhjetor 2019

Ky raport u hartua nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadrin e projektit ‘Fuqizimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri,’ i mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

RAPORTIMI I MEDIAS MBI REFORMËN NË DREJTËSI, TETOR-DHJETOR 2019

Periodha në monitorim përkon me tre zhvillime tepër të rëndësishme për Reformën në Drejtësi duke u bërë një ndër tremujorët me intensitetin më të lartë të raportimeve në media. Gjatë tremujorit të katërt të vitit u finalizua një ndër projektet më të rëndësishme të Reformës, siç është ngritja e SPAK dhe zgjedhja e kreut të saj, duke përmyllur kështu të gjithë strukturën e re të hetimit në vend sipas përcaktimeve të Reformës në Drejtësi. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe përfunduan procedurat për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të vendit, si dhe u bë funksionale Gjykata Kushtetuese.

Të gjitha këto zhvillime janë pasqyruar gjerësisht në media, siç konstatohet edhe në monitorimin e bërë për gjashtë media me një audiencë të mirëfilltë.

Këtë tremujor janë përzgjedhur të monitorohen edicionet qendrore të lajmeve të televizioneve informative “Abc News Albania” dhe “Report TV”, ndërsa nga mediat online janë monitoruar “Mapo Online” dhe “Shqiptarja.com”, të cilat kanë redaksi të posaçme për përmbajtjen online, duke dhënë një pasqyrë më të plotë mbi mbulimin e zhvillimeve në Reformën në Drejtësi, si dhe specifikat e raportimit për të.

Sa i përket mediave të printuara këtë tremujor janë përzgjedhur si kampion “Gazeta Tema” dhe gazeta “Liberale”.

Monitorimi u krye gjatë periudhës 1 tetor-15 dhjetor dhe fokusi ka qenë te raportimet mbi Reformën në Drejtësi në përgjithësi, dhe specifikisht bërja funksionale e SPAK-ut dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe zgjedhja e Kryeprokurorit të Republikës së Shqipërisë.

Në portale, monitorimi është bërë çdo ditë, përgjatë tre muajve, në rubrikat “Aktualitet/Politikë” ku edhe është konstatuar se janë klasifikuar lajmet për Reformën në Drejtësi.

Fillimisht janë identifikuar të gjitha publikimet mbi Reformën në Drejtësi, në përgjithësi, duke i nëngrupuar më pas në lajme mbi vettingun, funksionimin e institucioneve apo mbi KLP/KLGJ/SPAK.

Në përfundim të monitorimit është bërë një vlerësim cilësor dhe statistikor i përmbajtjes. Pas zbulimit të numrit total të lajmeve në rubrikat përkatëse dhe numrit total të lajmeve mbi Reformën në Drejtësi, është nxjerrë në përqindje edhe vendi që zënë publikimet mbi reformën në tërësinë e lajmeve të nxjerra në rubrikat në fjalë.

Po ashtu janë monitoruar 90 numra të gazetave “Tema” dhe “Liberale”, si dhe 45 edicione lajmesh të “Abc News Albania” dhe “Report Tv”, duke listuar të gjitha lajmet mbi Reformën dhe institucionet e lidhura me të.


Në përfundim është bërë një vlerësim statistikor dhe cilësor mbi zhvillimet që lidhen kryesisht me ngritjen e SPAK-ut, të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

1. PASQYRË E GJETJEVE STATISTIKORE

1.1 Televizionet

Ngritja, fillimi nga funksionimi dhe zgjedhja e kreut të SPAK-ut, përplasja institucionale mes Presidencës dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm kanë qenë ngjarjet që mbizotëruan tremujorin e fundit të këtij viti, duke u mbuluar gjerësisht nga mediat dhe specifikisht nga televizionet informative. Këto të fundit, në jo pak raste gjatë edicioneve të lajmeve, kanë bërë edhe lidhje direkt me gazetarët e terrenit për të raportuar mbi zhvillimet në fjalë,

Mbulimi i gjerë është i ngjashëm me periudhën kur po diskutoheshin ndryshimet Kushtetuese dhe më pas miratimi i tyre në Kuvend, nisur edhe nga fakti se tashmë u finalizua, të paktën institucionalisht, e gjithë struktura e re e Drejtësisë, sipas parashikimeve të Reformës.



Figurë 1 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në televizionet "Abc News Albania" dhe "Report TV" gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019

Nga monitorimi rezulton se të dy televizionet “Abc News Albania” dhe “Report TV” kanë bërë një mbulim në detaje të zhvillimeve në fjalë me disa diferenca të vogla, të cilat vijnë më tepër për shkak të formatit të edicioneve të lajmeve, se sa nga politika editoriale. Rezulton se edicionet e lajmeve në “Report TV” zgjasin më tepër se sa tek “Abc News Albania”, duke numëruar gjithashtu më tepër kronika në tërësi. “Abc News Albania” ndërkohë raporton me kronika më të shkurtra me përmbajtje më të përqendruar.

Një fakt i tillë konstatohet edhe nëse krahasojmë numrin e kronikave mbi Reformën në Drejtësi të transmetuara në të dy televizionet. “Report TV” ka transmetuar në 696 kronika në edicionet e lajmeve të marra si kampion, nga të cilat 47 ose 6.75 për qind e totalit kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi apo zhvillimet që lidhen me të.

Nga ana tjetër, rezulton se gjatë të njëjtës periudhë në edicionet e marra si kampion, “Abc News Albania” ka transmetuar 440 kronika, nga të cilat 31 ose 7 për qind e totalit kanë qenë mbi Reformën në Drejtësi apo zhvillimet që lidhen me të.

Vlen të theksohet se “Abc News Albania” ka ndjekur më nga afër se sa “Report TV” përplasjen institucionale mes Presidencës dhe KED-së për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë edhe një shpjegim më të detajuar të shkakut të kësaj problematike.

“Report TV” vërehet të ketë qenë më i predispozuar në raportimin e lajmeve nga veprimtaria e KPK-së, e cila pasqyrohet tërësisht edhe në të dhënat statistikore. Kështu, “Report TV” ka transmetuar 16 kronika mbi vettingun krahasuar me 6 kronika të “Abc News Albania”. Raporti ngushtohet tek kronikat mbi KLGJ/ KLP/SPAK dhe institucionet e tjera, ku “Report TV” rezulton të ketë transmetuar 31 kronika, kryesisht mbi KLP-së dhe SPAK-ut, kundrejt 25 kronikave të “Abc News Albania”.

Ngritja e SPAK-ut dhe zgjedhja e kreut të saj rezulton të jetë një ngjarje me pasqyrimin më të lartë krahasuar me institucionet e tjera si KLP apo KLGJ, nisur edhe nga pritshmëritë e qytetarëve mbi ndikimet që do të sjellë funksionimi i Prokurorisë Speciale. Konstatohet se të dy televizionet kanë bërë lidhje të shpeshta live me gazetarët e terrenit, të cilët raportnin vazhdimisht mbi zhvillimet e reja, siç ishte për shembull ecuria e votimit për zgjedhjen e kreut të SPAK-ut.

Një mbulim i ngjashëm u vërejt edhe për garën për Prokurorin e Përgjithshëm, që nga vendimet e KLP-së deri te votimi i emrave të kandidatëve në Kuvend, e cila u raportua live në të dy televizionet. Konstatohet gjithashtu se televizionet e monitoruara kanë patur objekt të raportimit

të tyre, në disa kronika, edhe veprimtarinë e kreut të ri të Prokurorisë së Përgjithshme, siç janë takimet në prokuroritë e rretheve fill pas marrjes së detyrës.

1.2. Mediat online

Zhvillimet e rëndësishme gjatë periudhës në monitorim janë pasqyruar tërësisht te përmbajtja e mediave online, të cilat ndryshe nga mediat audiovizive apo ato të printuara nuk kanë kufizime sa i përket hapësirës. Rrjedhimisht, në këto media vërehet një numër më i madh lajmesh mbi zhvillimet që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi, ku pasqyrim gjejnë edhe qëndrime të institucioneve apo politikanëve periferikë.


Vlen të theksohet se gjatë monitorimit të “Shqiptarja.com” dhe “Mapo Online” janë konstatuar një numër i madh lajmesh që kanë patur si burim partitë politike.

Rasti tipik është ai i përplasjes Presidencë-KED-mazhorancë mbi emërimet në Gjykatën Kushtetuese, gjatë të cilës si te “Shqiptarja.com”, ashtu edhe te “Mapo Online” vërehet të jenë hedhur nga 3-4 publikime në ditë me burim nga partitë politike.

Karakteristikë e këtyre lajmeve është hyrja e shkurtër, citimi i gjatë dhe mungesa e kontekstit në pjesën më të madhe të rasteve, ku përveç akuzave që palët i bëjnë njëra-tjetrës në publikim nuk gjendet asnjë informacion tjetër shtesë që të shpjegojë kontekstin e akuzave, por edhe të debatit, për të cilin po ndeshen palët.

Kjo përmbajtje vërehet vetëm pasi në këto media online postohen lajmet e versioneve të tyre print, të cilat janë më të gjata dhe më analitike krahasuar me përmbajtjen online.

Nga monitorimi konstatohet se “Shqiptarja.com” ka publikuar një numër më të madh lajmesh mbi Reformën në Drejtësi krahasuar me “Mapo Online”. Të dyja mediat kanë redaksi të dedikuara online dhe nuk konstatohet të jetë shkak politika editoriale, ndërkohë që diferenca duket se është krijuar për shkak se “Shqiptarja.com” është njëherësh edhe dritarja e lajmeve të redaksisë së televizionit “Report TV”.




Figurë 2 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në median online "Shqiptarja.com" gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019

Gjatë periudhës së monitoruar të rubrika "Aktualitet" e "Shqiptarja.com" janë konstatuar 3 902 publikime, nga të cilat 180 ose 4.6 për qind e totalit kanë të bëjnë me Reformën. Nga këto, 60 lajme kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit të figurave, siç është vetting, dhe 117 me SPAK/KLGJ/KLP.

Sa i përket "Mapo Online", në rubrikën "Aktualitet" të kësaj medieje janë konstatuar gjithsej 2 706 publikime, nga të cilat 120 ose 4.4 për qind e totalit kanë të bëjnë me Reformën.

Nga këto, 17 lidhen me vettingun, kurse 104 me SPAK/KLGJ/KLP.



Figurë 3 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në median "Mapo Online" gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019

Kjo diferencë e madhe e publikimeve mbi grupin e lajmeve që kanë të bëjnë me SPAK/KLGJ/KLP lidhet me faktin se gjatë kësaj periudhe ka patur mjaft mbledhje të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për intervistimin e kandidatëve për Kryeprokuror, kandidatëve për kreun e SPAK-ut apo edhe votimin për këtë të fundit.


1.3. Shtypi

Për shkak të zhvillimeve të rëndësishme, gjatë periudhës së monitoruar, vërehet se në një pjesë të mirë të rasteve, lajmet që kanë të bëjnë me Reformën kanë gjetur pasqyrim në faqen e parë të gazetave të monitoruara.

Si gazeta “Tema”, ashtu dhe gazeta “Liberale” e kanë trajtuar Reformën në Drejtësi si një nevojë për vendin, duke patur një qëndrim të njëjtë sa i përket domosdoshmërisë për ta kryer atë, ndërsa qëndrimet kanë të bëjnë me mënyrën si ajo po implementohet.

Nga monitorimi konstatohet se në rastet e zhvillimeve të ngarkuara me ngjyrime politike, siç ka qenë përplasja për emërimet në Gjykatën Kushtetuese, rezulton se “Tema” ka mbajtur një qëndrim të ngjashëm me atë të mazhorancës, ndryshe nga “Liberale” që ka ndërthurur në raportim qëndrime të palëve të ndryshme. Njërin nga numrat e gazetës, pikërisht atë të datës 16


nëntor, “Liberale” e hap me titullin “Knockdown-i i parë për Reformën¹” duke theksuar se padia e Presidentit Meta ndaj kreut të KED-së, Ardian Dvorani, dhe i gjithë debati që parapriu, është pikërisht një sfidë ndaj Reformës.



Figurë 4 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në gazeta "Tema" gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019

Gjatë tre muajve të monitoruar, “Tema” ka publikuar 61 lajme që kanë të bëjnë me Reformën, ku pjesa më e madhe, 38 të tillë, kanë të bëjnë kryesisht me SPAK-un dhe KLP-në, kurse pjesa tjetër lidhet me vettingun e disa emrave të njohur të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ndërkohë, “Liberale”, nisur edhe nga formati i saj, ka postuar më pak lajme në numër, por vërehet se përmbajtja në publikimet e bëra për Reformën është më e gjerë, duke përfshirë edhe qëndrime të ndryshme. Konstatohet se gazeta ka publikuar 46 lajme mbi Reformën gjatë periudhës së monitoruar, ku 32 prej tyre janë për KLP/SPAK/KED, kurse pjesa tjetër kanë të bëjnë me vettingun.

¹ <https://liberale.al/knockdown-i-pare-per-reformen/>



Figurë 5 Pasqyrë statistikore e gjetjeve në gazeta "Liberale" gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019

Ndryshe nga raportimi i televizioneve dhe mediave online, te shtypi i shkruar konstatohen edhe qëndrime editoriale në lidhje me zhvillime të caktuara, siç është përplasja për Gjykatën Kushtetuese apo zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. ÇËSHTJET KRYESORE DHE PROBLEMATIKAT

2.1. Ngritja e SPAK-ut, mes mungesash dhe pritshmërisë për rezultate të shpejta

Ngritja, bërja funksional dhe zgjedhja e kreut të SPAK-ut është ngjarja që ka mbizotëruar raportimin mbi Reformën në Drejtësi sa i përket përmbajtjes, gjatë gjysmës së dytë të vitit. Përshpejtimi i punës për të emëruar prokurorët që do të ishin pjesë e strukturës, dhe më pas intervistimi i kandidatëve për kreun e saj, apo edhe zgjedhja e tij, bënë që mediat të fokusohen ndjeshëm mbi këtë zhvillim.

Vërehet një perceptim i përgjithshëm në publik, që buron nga artikulli i politikanëve, por edhe nga raportimi mediatic, se SPAK-u do të jetë struktura që do të “burgosë politikanët e korruptuar” duke e ngushtuar kështu aktivitetin e këtij institucioni. Në jo pak raste lajmet mbi

SPAK-un janë raportuar me titujt: “Kush janë prokurorët që do të hetojnë politikanët”² apo “Prokurorët që do të bëjnë “zap” politikanët e korruptuar”.

Një ndër problemet që shoqëruan procesin e ngritjes së SPAK ka qenë mungesa e prokurorëve që mund të përmbushnin kushtet për të qenë pjesë e strukturës, gjë që zvarriti procesin deri sa KLP-ja gjeti një hapësirë ligjore për ta bërë funksional edhe me tetë anëtarë³. Ky fakt ka gjetur pasqyrim të gjerë në media⁴, ku janë shpjeguar detajet se si do të gjendet zgjidhja për ta bërë SPAK-un funksional edhe me tetë anëtarë.

“Liberale” hapet me titullin “Vetëm tetë kundër krimit”, më datë 20 dhjetor, duke theksuar pikërisht faktin se që e pamundur që SPAK-u të ngrihej me 15 prokurorë, siç përcaktohet në ligj. “Abc News Albania” raporton gjithashtu se ishin vetëm tetë prokurorë që u betuan te Presidenti Meta duke shpjeguar edhe procesin e zgjedhjes së tyre⁵.

Vlen të theksohet fakti se gjatë gjithë kësaj periudhe mediat kanë publikuar⁶ detaje nga karriera e prokurorëve të SPAK-ut dhe kandidatëve për drejtimin e strukturës, duke iu referuar shpesh edhe të dhënave nga Autoriteti për Informim mbi Dosjet e Ish-Sigurimit.

Një interes i veçantë nga media gjatë ngritjes së SPAK-ut është treguar edhe për mbylljen e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, dhe faktin se cilat nga dosjet e rëndësishme do të kalonin në administrimin e këtyre prokurorëve. “Abc News Albania” bën, më datë 26 nëntor⁷, një listim të dosjeve të Krimeve të Rënda që do të kalojnë në SPAK, duke i klasifikuar ato sipas akuzave.

² <https://liberale.al/spak-do-te-hetoje-edhe-politikanet-vjen-reagimi-i-pare-nga-ps/>

³ <https://shqiptarja.com/video/klp-miraton-propozimin-e-komisionit-te-posacem-spak-gati-brenda-muajit-nentor>

⁴ <http://abcnews.al/te-henen-emerohen-tete-prokuroret-e-rinj-te-spak/>

⁵ <http://abcnews.al/spak-nis-nga-puna-fotot-e-betimit-ne-presidencefoto-betohen-ne-presidence-8-prokuroret-ge-do-hetojne-zyrtaret-e-larte-shqiptare/>

⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/nis-mbledhja-e-keshillit-te-larte-te-prokurorise-pritet-emerimi-i-8-prokurore-ve-te-pare-te-spak>

⁷ <http://abcnews.al/rreth-176-ceshtje-cilat-jane-dosjet-ge-do-te-kalojne-tek-spak/>

Në të njëjtën linjë raporton edhe “Shqiptarja.com” më datë 6 dhjetor⁸, ku shpjegohet se cilat dosje u kalojnë prokurorive të rretheve dhe cilat SPAK-ut. Kërkesa e Kryeprokurorit të sapozgjedhur Olsian Çela ndaj prokurorëve që t’ia kalojnë SPAK-ut dosjet është urdhri i parë që ai u dha vartësve të tij gjatë takimit të prezantimit në godinën e Kryeprokurorisë⁹.

Asnjë prej partive politike nuk është shprehur publikisht kundër ngritjes së SPAK-ut, nisur edhe nga fakti se, qysh në fillim, ai u ngrit me perceptimin se do të hetonte politikanët duke bërë që çdo qëndrim kundër të lexohej si një shprehje e frikës dhe autoakuzës. Madje, kur u ngrit struktura në mes të dhjetorit, në kor partitë politike e përgëzuan një fakt të tillë. Nëse nuk pati sulme të drejtpërdrejta ndaj të gjithë strukturës, në media u vërejtën akuza ndaj prokurorëve të caktuar¹⁰, si dhe kreut të sapozgjedhur të këtij institucioni.

Një ndër problematikat kryesore që haset në raportime ka të bëjë me faktin se SPAK-u vërehet të portretizohet shpesh, në mediat që shihen si më pranë mazhorancës, si struktura që do të burgosë “X” apo “Y” lider opozitar¹¹.

Nga një krahasim i bërë mes numrit të shikimit të kronikave mbi vettingun e prokurorëve apo gjykatësve të caktuar dhe lajmeve mbi SPAK, rezulton se këto të fundit janë parë mesatarisht të paktën dy deri tri herë më tepër. Kjo tregon se krahas rëndësisë që mbart për Reformën në Drejtësi ngritja e SPAK-ut, një arsye tjetër që i ka shtyrë mediat të raportojnë gjerësisht zhvillimet mbi këtë strukturë mund të jetë edhe interesi i publikut.

2.2. Përplasja Presidencë-KED në emër të Kushtetutës

Përplasja mes Presidencës dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke rrezikuar të sjellë një ngërç ligjor në emërimet e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese, ishte lajm kryesor në të gjitha mediat gjatë fundit të nëntorit dhe javës së parë të dhjetorit.

⁸ <https://shqiptarja.com/lajm/shkrirja-e-krimave-tw-rwnda-1000-procedime-u-kalojne-rretheve-100-dosje-vip-tek-spak>

⁹ <https://shqiptarja.com/lajm/urdhri-i-pare-i-olsian-celes-per-prokuroret-kaloni-dosjet-e-zyrtareve-dhe-krimet-tek-spaku-ruani-sekretet>

¹⁰ <https://liberale.al/pd-integriteti-i-spak-ne-dyshim-faktet-ge-implikojne-dy-prokuroret/>

¹¹ https://shqiptarja.com/lajm/ajazi-po-sulen-ta-mbysin-edhe-spakun?r=read_more

Përplasja u finalizua me padinë e Presidentit të Republikës ndaj kreut të KED, e cila gjithashtu u pasqyrua gjerësisht për shkak të kontekstit të kësaj përplasjeje institucionale, e ndodhur për shkak të emërimeve në Gjykatën Kushtetuese, institucion ku do të finalizohet edhe procedura e nisur nga mazhoranca për shkarkimin nga detyra të Presidentit¹².

Mediat që shihen si më pranë qeverisë e kanë raportuar këtë ngjarje si një tentativë të Presidentit për të bllokuar apo emëruar në Kushtetuese kandidatët e tij të preferuar¹³, ndërsa mediat që shihen si më pranë opozitës janë fokusuar më tepër tek argumentet ligjore të Presidentit, mbi të cilat ky i fundit bazon akuzën ndaj kreut të KED-së¹⁴.

Përballja në gjykatë mes Presidentit të Republikës dhe kreut të KED-së ishte finalja e një përplasjeje disa mujore. Opinioni publik u bë dëshmitar i një debati ligjor që u konsumua më tepër në media mbi vlefshmërinë betimit diku tjetër dhe jo para Presidentit të një anëtari të Gjykatës Kushtetuese, duke shënuar kështu një precedent të rrallë në vend në këtë drejtim. Këtë zhvillim, “Report TV” e raporton me titullin “Vorpsi 'injon' Metën dhe nis punën, betohet te noterja dhe ia dërgon presidencës me postë”, ndërkohë që “Shqiptarja.com” shkruan se betimi i Vorpsit para noterës ishte një përgjigje ndaj refuzimit të Presidentit për të organizuar një ceremoni betimi për të. Në të njëjtën linjë raporton edhe “Tema”, e cila e konsideron këtë zhvillim si një tentativë të Presidentit për të bllokuar ngritjen e Gjykatës Kushtetuese¹⁵. “SPAK-u është institucioni i dytë që Ilir Meta po bllokoi pas Gjykatës Kushtetuese”, shkruhet në një publikim të gazetës, më datë 5 dhjetor.

Por, ndryshe e sheh “Liberale” këtë zhvillim. Gazeta hapet më datë 15 nëntor me titullin: “Betimi i rremë¹⁶” dhe përmes një editoriali shpjegohet se përse betimi para noterës është nul. Gazeta shkruan se “ky betim para noterit ishte teatri më i ri absurd për Kushtetuesen”.

¹² <https://www.gazetatema.net/2019/11/20/a-nis-te-premten-shkarkimi-i-ilir-metes-ne-komision-thirret-edhe-shish/>

¹³ <https://shqiptarja.com/lajm/presidenca-nuk-bllkohet-funksionimi-i-ked-nese-ardian-dvorani-merret-i-pandehur-nga-prokuroria>

¹⁴ <https://liberale.al/padia-kunder-kreut-te-ked-meta-publikon-videon-ne-anglisht/>

¹⁵ <https://www.gazetatema.net/2019/12/05/a-po-e-bllokon-ilir-meta-spaku-n-si-gjykatën-kushtetuese/>

¹⁶ <https://liberale.al/betimi-i-rreme/>

Kjo përplasje, për shkak edhe se ishte bazuar tërësisht mbi teknikalitete ligjore, nxori në pah gjithashtu problematikat e raportimit të gazetarëve në këtë sektor. Në pamundësi për të bërë një raportim shterues për shkak të njohurive të duhura dhe në një ambient të polarizuar politikisht, mediat janë detyruar të bëjnë vetëm transmetimin e qëndrimeve të palëve të përfshira në proces.

2.3. Kryeprokurori dhe zgjedhja që nuk befasoi askënd

Procedurat për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe votimi në Kuvend përkuan në kohë me dy zhvillime të tjerë të rëndësishme për Reformën, siç ishte ngritja e SPAK-ut dhe përplasja institucionale Presidencë-KED për emërimet në Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, kjo ngjarje e rëndësishme nuk mori të njëjtën vëmendje mediatike si dy ngjarjet e mësipërme, gjë që konfirmohet edhe nga diferenca në numrin e kronikave të transmetuara në televizione apo lajmeve të publikuara në mediat online dhe ato print.

Kështu për shembull, gjatë periudhës 15 nëntor-15 dhjetor, fjala SPAK dhe KED janë përmendur përkatësisht 42 dhe 29 herë në mediat online të monitoruara, ndërsa fjala “Kryeprokuror” është përmendur 18 herë.

Ngritja e SPAK-ut dhe përplasja Presidencë-KED ishin ngjarje të rëndësishme, por duhet theksuar se zgjedhja e Kryeprokurorit nuk u shoqërua me një debat politik, apo me akuza mes palëve të përfshira, duke u kaluar si një zhvillim normal në Sistemin e Drejtësisë. Po ashtu, me ndryshimet e mëdha të kryera në Sistemin e Drejtësisë, posti i Prokurorit të Përgjithshëm tani nuk ka të njëjtat kompetenca ekzekutive si më parë. Një pjesë të kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm, që kanë të bëjnë me emërimet e prokurorëve, i ka marrë KLP-ja, kurse me ngritjen e SPAK-ut shkrihet gjithashtu Prokuroria e Krimeve të Rënda¹⁷.

Zgjedhja e Kryeprokurorit nuk u shoqërua me të papritura, pasi qysh në mëngjesin e datës 5 dhjetor, kur edhe do të votohej në Kuvend, Grupi Parlamentar i PS-së njoftoi se do të mbështeste Olsian Çelën¹⁸. Ky i fundit u zgjodh me 101 vota në krye të Prokurorisë së Përgjithshme¹⁹.

¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=Hfy-VcwjR0A>

¹⁸ <http://abcnews.al/e-fundit-ps-do-te-votoje-olsian-celen-si-kryeprokuror/>

¹⁹ <https://gazetamapo.al/lajmi-i-fundit-olsian-cela-zgjidhet-prokuror-i-pergjithshem/>

Nisur nga këto rrethana, raportimi mbi zgjedhjen e Kryeprokurorit nga mediat u mbulua në mënyrë korrekte, duke u fokusuar te procedura ligjore, platformat e kandidatëve dhe pritshmëritë ndaj këtij institucioni për të hetuar çështje të caktuara²⁰.

PËRFUNDIME

Tremujori i fundit i vitit 2019 përkoi edhe me një mori zhvillimesh të rëndësishme për institucionet e ngritura në kuadër të Reformës në Drejtësi, duke stimuluar edhe një vëllim të madh të përmbajtjes mediatike. Kështu, gjatë kësaj periudhe u zgjodh Kryeprokurori i ri i vendit pas procedurave që zgjatën disa muaj, ndërkohë që u ngrit dhe filloi së funksionuari struktura e SPAK-ut. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, gazetarëve iu desh të raportnin mbi përplasjen institucionale Presidencë-Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që ndodhi kryesisht në rrafsh teknik duke u kthyer në një sfidë për median që duhej të zbrëthente thelbin e konfliktit dhe raportimin në një formë sa më të kuptueshme për audiencën.

Të treja këto zhvillime të rëndësishme konfirmuan faktin se në median shqiptare ka redaksi ku raportohet në mënyrë profesionale, duke patur njohuri të plota mbi institucionet e reja të Reformës në Drejtësi, dukuri kjo që ka ardhur në përmirësim nga tremujori në tremujor qysh prej fillimit të këtij monitorimi, nisur edhe nga trajnimet e vazhdueshme të bëra me gazetarët.

Për shkak të operacionit të thellë që u krye në të gjithë Sistemin e Drejtësisë, gazetarët u ndjenë të detyruar që të thellonin njohuritë e tyre mbi rolin dhe funksionimin e institucioneve të reja.

Vërehet një përmirësim i dukshëm në raportim edhe në mediat online. Të dyja mediat online të zgjedhura si kampion për këtë tremujor kanë redaksi të dedikuara. Po ashtu, këto redaksi janë mbështetur me njohuri profesionale edhe nga kolegët e tyre, nga “Report TV” në rastin e “Shqiptarja.com”, dhe gazeta “Mapo” në rastin e “Mapo Online”, duke sjellë raportime cilësore.

Nga monitorimi nuk është konstatuar asnjë media që të jetë kundër kryerjes së Reformës në Drejtësi, ndërsa janë hasur raportime që kritikojnë aspekte të saj. Konstatohet një rezistencë ndaj vendimeve të caktuara të KPK-së ndaj prokurorëve apo gjyqtarëve të caktuar, sa herë këto

²⁰ <https://shqiptarja.com/lajm/hetimet-per-termetin-e-26-nentorit-cela-mbledh-prokuroret-e-tiranes>

vendime nuk janë të njëjta me pritshmëritë e opinionit publik për figura të caktuara në Sistemin e Drejtësisë, të cilët kanë spikatur pozitivisht apo negativisht.

Në jo pak raste janë hasur raportime kritike mbi veprimtarinë e Komisionerit Publik, për shkak të “qasjeve preferenciale” ndaj personazheve të caktuar që rivlerësohen nga KPK.

Gjatë monitorimit vijon të vërehet një perceptim i përgjithshëm, sipas të cilit ngritja e SPAK-ut do të shoqërohet menjëherë me arrestime të politikanëve të caktuar. Ky perceptim është ushqyer edhe nga raportimet e medias, të cilat e kanë përmbledhur aktivitetin e SPAK-ut vetëm në këtë drejtim.

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy



PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT